

2023



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Financave

**RAPORTI VJETOR
PËR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR PUBLIK
PËR VITIN 2023**

Shkup, korrik 2024

PËRMBAJTJE

	Faqet
REZYME.....	4
1.HYRJE.....	6
1.1 Baza ligjore për hartimin e raportit vjetor	6
1.2 Qëllimi i raportit vjetor.....	6
1.3 Baza e hartimit dhe përfshirja e raportit vjetor.....	6
1.4 Raportet e dorëzuara vjetore financiare për vitin 2023.....	7
2. GJENDJA E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR NË VITIN 2023.....	9
2.1. ANALIZA E PYETËSORIT PËR VETËVLERËSIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT FINANCIAR.....	9
A. MJEDISI I KONTROLLIT.....	10
B. MENAXHIMI I RISQEVE.....	15
C. KONTROLLI.....	18
Ç. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI.....	19
D. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SISTEMIT.....	21
3. RAPORTI I REVIZIONEVE TË REALIZUARA DHE AKTIVITETET E REVIZIONIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2023.....	22
3.1 Gjendja e revizionit të brendshëm sipas evidencës së Njesisë Qendrore të Harmonizimit	22
3.1.1 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm te subjektet e sektorit publik në nivel qendror dhe lokal	22
3.1.2 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm te shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal.....	22
3.1.3 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm te ministrinë.....	23
3.2 Gjendja e revizionit të brendshëm sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2023	25
3.2.1 Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel qendror sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2023.....	25
3.2.2 Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel lokal sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2023.....	27
4. NJËSIA QENDRORE E HARMONIZIMIT.....	30
4.1 Aktivitetet e realizuara të Njesisë Qendrore të Harmonizimit në vitin 2023	32
4.1.1 Aktivitetet e Njesisë Qendrore të Harmonizimit në lidhje me Kapitullin 32 – Kontrolli financiar.....	32
4.2 Raportime ndaj konkluzioneve të Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2022.....	32
KONKLUZIONE.....	35
SHTOJCA.....	37
1. Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë dorëzuar raport financiar vjetor	
2. Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë miratuar Strategji për menaxhimin e risqeve	

3. *Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë hartuar Regjistër të Riskeve*
4. *Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë dorëzuar raporte për revizionet e realizuara dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm*
5. *Pasqyra përmbledhëse e mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara dhe përqindja e realizimit sipas shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror*
6. *Pasqyra përmbledhëse e raporteve për programin/projektin/marrëveshjen e realizuar te shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror*
7. *Pasqyra përmbledhëse e mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara dhe përqindja e realizimit te njësitë e vetëqeverisjes lokale*
8. *Pasqyra përmbledhëse e raporteve për programin/projektin/marrëveshjen e realizuar te njësitë e vetëqeverisjes lokale*

REZYME

Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik tregon shkallën e zhvillimit të menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe revizionit të brendshëm për të informuar Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe palët e tjera të involvuara për aktivitetet e kryera në periudhën raportuese.

Raporti është hartuar në bazë të raporteve financiare vjetore të dorëzuara për vitin 2023 nga shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal dhe evidencës së Njesisë Qendrore të Harmonizimit.

Detyrimin për dorëzimin e Raportit vjetor financiar për vitin 2023 e kanë përmbushur 96% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe 75% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel lokal, që krahasuar me vitin paraprak paraqet rritje prej 8 pikë përqindjeje në nivel qendror ndërsa në nivel lokal nuk ka ndryshim nga viti i kaluar.

Analiza e të dhënave nga vetëvlerësimet e dorëzuara tregon se të punësuarit të rreth 96% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal janë të informuar me Kodin e etikës së nëpunësve shtetërorë ose Kodin e veçantë të shfrytëzuesve buxhetorë, por ekzistojnë vështirësi në raportimin dhe parandalimin e konflikteve të mundshme të interesit.

Udhëheqësia dhe stili i menaxhimit të shfrytëzuesve buxhetorë është në nivel të lartë profesional, me ç'rast mbahen rregullisht takime në nivelin më të lartë të udhëheqësisë (në 94% të institucioneve mbahen këto kolegji të rregullta) dhe lidhur me to janë përfshirë tema që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe kontrollin financiar (realizimin e qëllimeve strategjike, zbatimin e programeve dhe projekteve, shkallën e rezultateve të arritura, risqet kryesore gjatë punës dhe realizimin e planit/buxhetit financiar). Analiza e të dhënave nga aktvendimet e dorëzuara për shpërndarjen e brendshme të buxhetit dhe kompetencat e përgjithshme në Njësine Qendrore të Harmonizimit tregon se 72% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe 74% e komunave dhe Qytetit të Shkupit kanë buxhet të shpërndarë sipas njësive organizative, ndërsa vetëm 49% e udhëheqësve të njësive organizative të shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe 42% e komunave dhe Qytetit të Shkupit kanë kompetenca të përgjithshme për ndëmmarrjen e detyrimeve financiare, që tregon mungesë të mjaftueshme të linjave të qarta të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së udhëheqësve. Në nivel qendror, rreth 71%¹ e shfrytëzuesve buxhetorë kanë miratuar Strategji të menaxhimit të riskut, 78% e shfrytëzuesve buxhetorë i dokumentojnë risqet gjatë punës së tyre në Regjistrin e Riskut, ndërsa rreth 69% i dokumentojnë risqet në dokumentet e tyre të planifikimit.

Në nivel lokal, rreth 46%² e shfrytëzuesve buxhetorë kanë miratuar Strategji të menaxhimit të rrishtit, 42% e shfrytëzuesve buxhetorë i dokumentojnë rrishtet në punën e tyre në Regjistrin e Riskut, ndërsa rreth 53% i dokumentojnë rrishtet në dokumentet e tyre të planifikimit.

¹ dhe ² Nga evidenca e Njesisë Qendrore të Harmonizimit

Nga të dhënat e Njesisë Qendrore të Harmonizimit, numri i institucioneve në sektorin publik që përcaktojnë risqet e korrupsionit dhe mashtrimit në punën e tyre është ende i vogël.

Është i nevojshëm përmirësimi i dokumentacionit të risqeve në Regjistrin e Riqseve, ku do të përfshihen edhe risqet e korrupsionit, si dhe sistemi i raportimit për risqet e identifikuara dhe zbatimi i masave për reduktimin e tyre në mënyrë të tillë që personi përgjegjës i institucionit do të marrë informacione në kohë për risqet më të theksuara të institucionit dhe institucioneve kompetente. Nga gjithsej 178 shfrytëzues buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, 113 shfrytëzues buxhetorë (63.4%, që është 9.8 pikë përqindje më shumë se viti paraprak), kanë dorëzuar raporte për revizionet e kryera dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm, përkatësisht 65 shfrytëzues buxhetorë nga niveli qendror (67%) dhe 48 shfrytëzues buxhetorë (59.2%) nga niveli lokal.

Nga gjithsej 178 shfrytëzues buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, raport për revizionet e kryera dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm kanë dorëzuar 113 shfrytëzues buxhetorë (63.4%, që është 9.8 pikë përqindje më shumë se viti paraprak), përkatësisht 65 shfrytëzues buxhetorë në nivel qendror (67%) dhe 48 shfrytëzues buxhetorë (59.2%) në nivel lokal.

Nga analiza e të dhënave për gjendjen e revizionit të brendshëm në subjektet e sektorit publik rezulton se në vitin 2023, krahasuar me vitin paraprak në nivel qendror dhe lokal, numri i përgjithshëm i revizioneve të brendshëm është ulur për një (0.5%), ndërsa numri i udhëheqësve mbetet i njëjtë për shkak të rritjes së këtij numri në nivel qendror, ndërsa në nivel lokal është ulur për një.

Në vitin 2023, përqindja e realizimit të rekomandimeve të revizionit të brendshëm në nivel qendror është ulur për 4 pikë përqindjeje, përkatësisht nga 66.5% në 62.5%, ndërsa në nivel lokal është rritur për 2 pikë përqindjeje, përkatësisht nga 61.4% në 63.4%.

Me qëllim të tejkalimit të mangësive të konstatuara në këtë raport, jepen konkluzione për veprime të mëtejshme, realizimi i të cilave do të monitorohet nga Ministria e Financave – Sektori i Harmonizimit Qendror të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik.

1. HYRJE

Sektori i Harmonizimit Qendror të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik në Ministrinë e Financave, si Njësia Qendrore e Harmonizimit (NJQH) është njësi organizative përgjegjëse për harmonizimin e aktiviteteve për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik. Sipas Ligjit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik³, NJQH-ja është përgjegjëse për përgatitjen e Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik.

Raporti vjetor ka për qëllim që ta elaborojë gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar të shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal.

Sistemi i kontrollit të brendshëm financiar në sektorin publik është krijuar për të siguruar menaxhim të duhur financiar, i cili nënkupton arritjen e qëllimeve të përcaktuara në mënyrë etike, nëpërmjet shfrytëzimit të ligjshëm, korrekt, ekonomik, efektiv dhe efikas të mjeteve.

Për shkak të kompleksitetit të tij, kontrolli i brendshëm financiar kërkon monitorim dhe vlerësim të vazhdueshëm të përshtatshmërisë dhe funksionalitetit të tij, i cili kryhet nëpërmjet vetëvlerësimit të sistemit nga udhëheqësit e institucioneve, si dhe aktiviteteve të revizionit të brendshëm.

Bazuar në atë që u theksua më sipër, në vazhdim të dokumentit është vërejtur shkalla e zhvillimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar të shfrytëzuesit buxhetorë në sektorin publik në vitin 2023, ndërsa janë propozuar edhe masa për zhvillimin e mëtejshëm të tij.

1.1 Baza ligjore për hartimin e raportit vjetor

Sipas nenit 48 alineja 10 të ligjit, raporti vjetor hartohet në bazë të analizës së Pyetëtorit për vetëvlerësimin e Sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe Raportit për revizionet e kryera dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm të dorëzuar me raportin financiar vjetor nga shfrytëzuesit buxhetorë në Ministrinë e Financave, si dhe aktivitetet e Njesisë Qendrore të Harmonizimit lidhur me zhvillimin e Sistemit të kontrollit të brendshëm financiar.

1.2 Qëllimi i raportit vjetor

Qëllimi i raportit vjetor është shqyrtimi i nivelit të zhvillimit të Sistemit të kontrollit të brendshëm financiar, informimi i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe palët tjera të involvuara për aktivitetet e realizuara në vitin 2023, si dhe përcaktimi i aktiviteteve për zhvillimin e mëtejshëm të menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe revizionit të brendshëm.

1.3 Baza e hartimit dhe përfshirja e raportit vjetor

Raporti vjetor për vitin 2023 është hartuar në bazë të analizës dhe prezantimit të të dhënave

³ “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 90/2009, 188/2013 dhe 192/15

të përmbledhura nga:

- Pyetësi i plotësuar për vetëvlerësimin e Sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar, si pjesë e raporteve të dorëzuara për aktivitetet lidhur me vendosjen dhe zhvillimin e menaxhimit dhe kontrollit financiar,
- raporti i dorëzuar për revizionet e kryera dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm dhe
- deklarata e dorëzuar për cilësinë dhe gjendjen e kontrollit të brendshëm, e dorëzuar nga shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë nga pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (përveç Entit Shtetëror të Revizionit), fondet, komunat dhe Qyteti i Shkupit.

Të dhënat e raporteve të dorëzuara financiare (Raporti për mjetet e planifikuara dhe të shpenzuara sipas zërave, Raporti për programet e realizuara, projektet dhe marrëveshjet, llogaritë vjetore ose llogaria vjetore e konsoliduar dhe Raporti për vetëvlerësimet e kryera)⁴ nga Njësia Qendrore e Harmonizimit janë analizuar dhe shfrytëzuar për verifikim me të dhënat/dokumentet që aktualisht dorëzohen në Njësine Qendrore të Harmonizimit.

Me qëllim të informimit gjithëpërfshirës të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe palëve tjera të involvuara për Sistemin e kontrollit të brendshëm financiar dhe për aktivitetet e kryera në vitin 2023, gjatë hartimit të raportit vjetor përfshihen edhe aktivitetet e Njesisë Qendrore të Harmonizimit, si dhe të dhënat nga dokumentacioni me të cilin disponon ajo.

1.4 Raportet e dorëzuara vjetore financiare për vitin 2023

Detyrimin për dorëzimin e raportit financiar vjetor (RFV) për vitin 2023 e kishin 178 shfrytëzues buxhetorë, prej të cilëve 97 në nivel qendror dhe 81 në nivel lokal (komunat dhe Qyteti i Shkupit).

Në vitin 2023, në nivel qendror 93⁵ shfrytëzues buxhetorë kanë dorëzuar RFV, që krahasuar me vitin paraprak është rritje prej 8 pikë përqindjeje, ndërsa 61 njësi të vetëqeverisjes lokale kanë dorëzuar RFV, që është e njëjtë krahasuar me vitin paraprak.

Tabela 1: Pasqyrë e numrit të shfrytëzuesve buxhetorë që kanë detyrim të dorëzojnë RFV për vitin 2023 dhe shfrytëzuesve buxhetorë që kanë dorëzuar RFV

Shfrytëzuesit buxhetorë	Numri i shfrytëzuesve	Numri i shfrytëzuesve	Numri i shfrytëzuesve	% e shfrytëzuesve buxhetorë që nuk	Ritja/ulja (pikë)
-------------------------	-----------------------	-----------------------	-----------------------	------------------------------------	-------------------

⁴ Shtojca 5 - Pasqyra përmbledhëse e mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara dhe përqindja e realizimit sipas shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror

Shtojca 6 - Pasqyra përmbledhëse e raporteve për programin/projektin/marrëveshjen e realizuar te shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror

Shtojca 7 - Pasqyra përmbledhëse e mjeteve të planifikuara dhe të shpenzuara dhe përqindja e realizimit te njësitë e vetëqeverisjes lokale

Shtojca 8 - Pasqyra përmbledhëse e raporteve për programin/projektin/marrëveshjen e realizuar te njësitë e vetëqeverisjes lokale

⁵ Nga të cilat 6 institucione në nivel qendror dhe 6 njësi të vetëqeverisjes lokale nuk dorëzuan “Raport për aktivitetet lidhur me vendosjen dhe zhvillimin e menaxhimit dhe kontrollit financiar”.

	buxhetorë që duhet të dorëzojnë RFV	buxhetorë që kanë dorëzuar RFV	buxhetorë që nuk kanë dorëzuar RFV	kanë dorëzuar RFV		përqindje)
				2022	2023	2022-2023
Niveli qendror	97	93	4	12%	4%	+8
Niveli lokal	81	61	20	25%	25%	0
Gjithsej	178	154	24	18%	13%	+5

(Shtojca 1. Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë dorëzuar raport financiar vjetor).

2. GJENDJA E SISTEMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM FINANCIAR NË VITIN 2023

2.1 ANALIZA E PYETËSORIT PËR VETËVLERËSIMIN E SISTEMIT TË MENAXHIMIT DHE KONTROLLIT FINANCIAR

Për shkak të kompleksitetit të tyre, sistemet e kontrollit të brendshëm kërkojnë monitorim dhe vlerësim të përshtatshmerisë dhe funksionalitetit përmes:

- vetëvlerësimin të sistemeve që po zbaton udhëheqja dhe
- aktivitetet e revizionit të brendshëm dhe të jashtëm.

Vetëvlerësimi i sistemeve realizohet duke plotësuar PyetëSORIN për vetëvlerësimin e Sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar, duke iu përgjigjur pyetjeve të grupuara në komponentët e mëposhtëm:

- mjedisi i kontrollit,
- menaxhimi i riskut,
- kontrolli,
- informacioni dhe komunikimi dhe
- monitorimi.

A. MJEDISI I KONTROLLIT

Mjedisi i kontrollit përfshin fushat e mëposhtme:

- etika dhe integriteti – integriteti personal dhe profesional, përkatësisht vlerat etike të të punësuarve dhe kompetencat e tyre,
- mënyra e udhëheqësisë dhe stili i menaxhimit,
- ekzistenca e qasjes së planifikimit gjatë punës (definimi i misionit, vizioni, përcaktimi i qëllimeve strategjike dhe lidhja e tyre me qëllimet operacionale, përkatësisht qëllimet vjetore),
- struktura organizative e rregulluar me kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për zbatimin e qëllimeve dhe menaxhimin e mjeteve buxhetore dhe
- vendosja e linjave të raportimit për qëllimet e arritura dhe mjetet e shpenzuara buxhetore.

a) Etika dhe integriteti

Analiza e të dhënave nga vetëvlerësimet e dorëzuara tregon se të punësuarit, respektivisht rreth 96% të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal janë të informuar me Kodin e etikës për të punësuarit shtetërorë. Megjithatë, numri i subjekteve të sektorit publik që kanë Kodin e tyre të veçantë të etikës, i cili publikohet në faqen e internetit të institucionit është ende i vogël, ndërsa të punësuarit janë të informuar me Kodin e etikës dhe vlerat etike të institucionit.

Në subjektet e sektorit publik ekziston ende pikëpamje e thjeshtësuar se vendimet rregullohen ose me ligj ose me vullnet të lirë. Kjo rezulton në arsyetimin e gabuar se nëse diçka është e ligjshme duhet të jetë etike dhe nuk njihet një fushë e tretë - etika. Për shkak të kësaj, shpesh lindin mosmarrëveshje dhe dilema etike, ndërsa e mira dhe e keqja nuk mund të njihen dhe të përcaktohen në mënyrë të qartë.

Kodi i etikës në praktikë duhet të kontribuojë që të punësuarit të fillojnë të mendojnë për çështjet etike përpara se të përballen me to dhe t'u mundësohet atyre ta refuzojnë përfshirjen në aktivitetet joetike, përkatësisht të përcaktohen kufijtë midis sjelljes së pranueshme dhe të papranueshme. Gjithashtu, Kodi i etikës dhe udhëzimet për zbatimin e tij duhet të ndihmojnë në njohjen dhe mësimin e të punësuarve në sjelljen etike, ndërsa udhëheqësit duhet ta përcaktojnë qartë se çfarë ata konsiderojnë sjellje joetike si parandalim të riskut të dëmtimit të reputacionit të institucionit.

Numri i subjekteve të sektorit publik (rreth 45%) që kanë vendosur rregulla të qarta (akte të brendshme) që përcaktojnë situatat e konfliktit të mundshëm të interesit, mënyrën e veprimit dhe masat për parandalimin e konflikteve të mundshme të interesit është i vogël, ndërsa gjithashtu nuk është emëruar person i autorizuar i etikës (vetëm 16% e subjekteve kanë emëruar), përkatësisht nuk janë krijuar strukturat etike në institucionet e sektorit publik, si: komitetet e etikës si grup drejtuesish të ngarkuar për mbikëqyrjen e sjelljes etike në institucion dhe për menaxhimin e temave të diskutueshme.

Tabela nr.2: Rezultatet nga sfera “Etika dhe integriteti”

Etika dhe integriteti	Viti 2023						2022	+/- 2023-2022
	Niveli qëndror		Niveli lokal		Gjithsej			
	87 Shfrytëzues buxhetorë		55 Shfrytëzues buxhetorë		142 Shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numri	%	Numri	%	Numri	%		
Informimi i të punësuarve me Kodin e etikës së nëpunësve shtetërorë ose Kodin e veçantë të shfrytëzuesit buxhetor.	83	95,40	54	98,18	137	96,48	93,1	3,38
Personi i emëruar (i autorizuar) i etikës	19	21,84	4	7,27	23	16,20	13,1	3,1
Ekzistimi i udhëzimeve të brendshme shtesë dhe/ose konstruksioneve për sjelljen e të punësuarve	57	65,52	27	49,09	84	59,15	57,9	1,25
Ekzistimi i rregullave të qarta (aktet e brendshme) që përcaktojnë situatat e konfliktit të mundshëm të interesit dhe mënyrën e veprimit.	41	47,13	23	41,82	64	45,07	40	5,07

b) Udhëheqësia dhe stili i menaxhimit

Analiza e të dhënave të pranura tregon faktin se udhëheqësia dhe stili i menaxhimit tek shfrytëzuesit buxhetorë është në nivel të lartë profesional, mbahen takime të rregullta në nivel më të lartë udhëheqës (në 94% të institucioneve mbahen kolegji të rregullta) dhe lidhur me to rregullisht diskutohen tema që kanë të bëjnë me menaxhimin dhe kontrollin financiar (realizimi i qëllimeve strategjike, zbatimi i programeve dhe projekteve, shkalla e rezultateve të arritura, risqet kryesore gjatë punës dhe zbatimi i planit/buxhetit financiar).

Krijohet komunikimi ndërmjet udhëheqësve dhe të punësuarve në mënyrë që të punësuarit të informohen me qëllimet e punës, rezultatet dhe ndikimet/efektet që priten, si dhe mënyrën e kontribimit të projekteve dhe aktiviteteve të tyre në arritjen e qëllimeve të punës së institucionit.

Është krijuar komunikim i rregullt ndërmjet niveleve më të larta të udhëheqësisë dhe udhëheqësve të tjerë. Në vitin 2023, në takimet e nivelit më të lartë të udhëheqësisë diskutohet për: qëllimet strategjike në 90% të institucioneve, zbatimi i programeve/projekteve dhe rezultatet e arritura në 92% të institucioneve, risqet kryesore gjatë punës në 85% të institucioneve, si dhe realizimi i planit/buxhetit financiar në 93% të institucioneve.

Megjithatë, nevojitet që të rritet përfshirja e udhëheqësve të organeve në kuadër të shfrytëzuesit buxhetor në takimet, veçanërisht në nivel qendror, sepse vetëm 32% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe 82% në nivel lokal, udhëheqësit e organeve në kuadër të shfrytëzuesit buxhetor përfshihen në takime.

Tabela nr. 3: Rezultatet nga sfera “Udhëheqësia dhe stili i menaxhimit”

Udhëheqësia dhe stili i menaxhimit	Viti 2023						2022	+/- 2023- 2022
	Niveli qendror		Nivel lokal		Gjithsej			
	87 shfrytëzues buxhetorë		55 shfrytëzues buxhetorë		142 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numri	%	Numri	%	Numri	%		
Mbajtja e takimeve të rregullta në nivel më të lartë të udhëheqësisë (kolegjiume)	85	97,70	48	87,27	133	93,66	91	2,66
Në takimet e nivelit më të lartë të udhëheqësisë diskutohet për:								
a) qëllimet strategjike	84	96,55	44	80	128	90,14	88,96	1,18
b) zbatimin e programeve/projekteve dhe arritjen e rezultateve	84	96,55	47	85,45	131	92,25	89,7	2,55
c) risqet kryesore gjatë punës	78	89,66	43	78,18	121	85,21	81,4	3,81
ç) realizimin e planit/buxhetit financiar	85	97,70	47	85,45	132	92,96	89,7	3,26
Në takimet e nivelit më të lartë të udhëheqësisë marrin pjesë edhe udhëheqësit e organeve në kuadër të shfrytëzuesit buxhetor	28	32,18	45	81,82	73	51,41	47,6	3,81

c) Qasja e planifikimit gjatë punës

Misioni dhe vizioni i institucioneve përcaktohen dhe publikohen në faqen e internetit të institucioneve dhe nevojiten që ato të përditësohen dhe përmirësohen rregullisht.

95% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë vendosur qëllime strategjike, ndërsa rreth 87% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë miratuar Planin vjetor të punës që do të mundësojë arritjen e mëtejshme të qëllimeve strategjike.

70% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë vendosur indikatorë të performancës përmes të cilëve monitorohet zbatimi i qëllimeve të përcaktuara, ndërsa te 82% e shfrytëzuesve buxhetorë, në dokumentet e planifikimit ku janë përfshirë të dhënat lidhur me qëllimet, përfshihen të dhëna për mjetet e vlerësuarra financiare të nevojshme për arritjen e qëllimeve të përcaktuara.

15.5% e institucioneve ende ka probleme në harmonizimin e ndërsjellë të qëllimeve strategjike, programore dhe operacionale, ndërsa institucionet kompetente (organet në kuadër, shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë, ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore) janë jo gjithmonë të informuar me qëllimet strategjike dhe objektivat programore të institucionit kompetent dhe nuk janë të përfshirë në zbatimin e tyre, ndërsa në kuadër të planeve të tyre operative jo gjithmonë janë të harmonizuara me objektivat strategjike dhe programore të institucionit kompetent.

Nevojitet përfshirje më e madhe e shfrytëzuesve buxhetorë të linjës së dytë në hartimin e dokumenteve strategjike.

Tabela nr. 4: Rezultate nga sfera “Qasja e planifikimit gjatë punës”

Qasja e planifikimit gjatë punës	Viti 2023						2022	+/- 2023-2022
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej			
	87 shfrytëzues buxhetorë		55 shfrytëzues buxhetorë		142 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numri	%	Numri	%	Numri	%		
Vizioni dhe misioni i përcaktuar i institucionit	84	96,55	45	81,82	129	90,84	84,8	6,04
Qëllimet e përcaktuara strategjike	85	97,70	50	90,91	135	95,07	90,3	4,77
Programet e përcaktuara	78	89,66	52	94,55	130	91,55	87,6	3,95
Qëllimet e përcaktuara të programeve	78	89,66	51	92,73	129	90,84	86,9	3,94
Qëllimet e programeve lidhen me qëllimet strategjike	77	88,51	49	89,09	126	88,73	84,1	4,63
Planit/programi i miratuar vjetor i punës	77	88,51	46	83,64	123	86,62	80,00	6,62
Në planin/programin vjetor të punës përcaktohen qëllimet që çdo njësi organizative duhet t'i arrijë gjatë vitit	70	80,46	42	76,36	112	78,87	76,5	2,37
Qëllimet e planeve/programeve vjetore të punës lidhen dhe harmonizohen me qëllimet strategjike	77	88,51	43	78,18	120	84,51	80,7	3,81
Në dokumentet e planifikimit në të cilat janë cekur të dhënat për qëllimet, përfshihen të dhëna për mjetet e vlerësuarra financiare të nevojshme për arritjen e qëllimeve të përcaktuara	74	85,06	43	78,18	117	82,39	77,2	5,19
Përcakton treguesit e performancës përmes së cilëve monitorohet zbatimi i qëllimeve të	72	82,76	27	49,09	99	69,72	62,1	7,62

përcaktuara.								
Në hartimin e dokumenteve strategjike është përfshirë edhe linja e dytë e shfrytëzuesve buxhetorë	8	9,20	38	69,09	46	32,39	29,7	2,69

ç) Struktura organizative, kompetencat dhe përgjegjësitë dhe sistemi i raportimit

Struktura e brendshme organizative është në përputhje me kornizën rregullatore dhe në shumicën e rasteve siguron ndarje të qartë të përgjegjësiave për zbatimin e kompetencave dhe qëllimeve të punës së subjekteve në sektorin publik. Vështirësitë ekzistojnë në ndarjen e kompetencave dhe përgjegjësiave për zbatimin e mbikëqyrjes mbi institucionet kompetente.

Struktura e brendshme organizative rregullohet me akte, Statut ose Rregullore për organizim të brendshëm, ndërsa me aktin e sistemit dhe me vendimet e përgjithshme rregullohen kompetencat dhe përgjegjësitë e udhëheqësve të njësisve organizative për zbatimin e qëllimeve dhe menaxhimin e burimeve financiare që u janë caktuar për shkak të përmbushjes së qëllimeve, kompetencave dhe përgjegjësisë lidhur me realizimin e projekteve që përfshijnë njësi të shumta organizative dhe/ose institucione kompetente.

Ndarja e kompetencave dhe përgjegjësiave në shpenzimin e mjeteve të aprovuara buxhetore sigurohet me miratimin e aktvendimit për ndarjen e brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar, me miratimin e aktvendimeve për dhënien e kompetencave të përgjithshme për ndërmarrjen e detyrimeve financiare, si dhe përmes kompetencës së përgjithshme për pagesën e udhëheqësit të Njesisë së Çështjeve financiare.

Aktvendime për ndarjen e brendshme të buxhetit të përgjithshëm të miratuar kanë 72% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe 74% e komunave dhe Qytetit të Shkupit. 49% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe 42% e komunave dhe Qytetit të Shkupit kanë aktvendime për kompetenca (autorizime) të përgjithshme.

Përprojekjet e mëtejshme janë të domosdoshme për vendosjen e linjave të qarta të raportimit, të cilat do t'ua mundësojnë udhëheqësve monitorimin e arritjes së qëllimeve të punës, mjeteve të alokuara financiare, rezultateve dhe ndikimeve, si dhe veçanërisht monitorimin e punës së institucioneve kompetente.

Tabela nr. 5: Rezultate nga sfera “Struktura organizative, kompetencat dhe përgjegjësitë dhe sistemi i raportimit”

STRUKTURA ORGANIZATIVE, KOMPETENCAT DHE PËRGJEGJËSITË DHE SISTEMI I RAPORTIMIT	Viti 2023						2022	+/- 2023- 2022
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej			
	87 shfrytëzues buxhetorë		55 shfrytëzues buxhetorë		142 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqin dje
	Numr i	%	Numri	%	Numr i	%		
Kompetenca dhe përgjegjësi të përcaktuara në mënyrë të qartë të njësisve organizative gjatë procesit të planifikimit strategjik	78	89,66	39	70,9 1	117	82,39	77,2	5,19
Autorizime dhe përgjegjësi të përcaktuara në mënyrë të qartë për arritjen e qëllimeve të	72	82,76	43	78,1 8	115	80,98	77,2	3,78

dakorduara të programit/projektit/aktivitetit								
Punët lidhur me koordinimin e zhvillimit të menaxhimit dhe kontrollit financiar janë në kompetencë të Njësisë së Çështjeve Financiare	69	79,31	41	74,5 5	110	77,46	75,9	1,56
Në njësitë organizative/organet e tjera, në përbërjen e tyre janë caktuar vendet e punës lidhur me financat	15	17,24	14	25,4 5	29	20,4	16,5	3,9
Udhëheqësit e njësive organizative kanë kompetenca për menaxhimin e mjeteve buxhetore që janë aprovuar për realizimin e aktiviteteve në kompetencat e tyre	57	65,52	34	61,8 2	91	64,08	57,9	6,18
Udhëheqësia më e lartë ka vendosur linja raportuese mbi arritjen e qëllimeve dhe lidhur me realizimin e buxhetit/planit financiar (qëllime të arritura, mjete buxhetore të shpenzuara, të ardhura të realizuara, detyrime të krijuara etj.)	72	82,76	45	81,8 2	117	82,39	77,9	4,49
Njësitë organizative përpilojnë raporte për arritjen e qëllimeve, programeve, projekteve	69	79,31	46	83,6 4	115	80,98	74,5	6,48
Njësitë organizative hartojnë raporte për realizimin e buxhetit të miratuar (mjete buxhetore të shpenzuara për realizimin e programeve, projekteve, aktiviteteve, të ardhurave, detyrimeve të dakorduara, etj.)	48	55,17	43	78,1 8	91	64,08	60	4,08

d) Menaxhimi i burimeve njerëzore

Rezultatet e analizës tregojnë se rreth 92% të shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal hartojnë plane trajnimi për të punësuarit lidhur me performancën e punës së tyre dhe rreth 77% mbajnë evidencë/regjistër të trajnimeve të kryera veçmas për secilin të punësuar.

Te 39% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal është vendosur praktika e caktimit të detyrave/aktiviteteve veçmas për secilin të punësuar në planet vjetore të punës së njësive organizative.

Në Ministrinë e Financave është themeluar Akademia e Financave Publike, e cila do të organizojë trajnime të vazhdueshme në fushën e financave publike në periudhën e ardhshme, duke siguruar mirëkuptim dhe veprim sipas ligjeve, akteve të tjera, akteve të brendshme, si dhe procedurave që i shfrytëzojnë institucionet për t'i reduktuar gabimet dhe parregullsitë gjatë punës, si dhe për sigurimin e shfrytëzimit të mjeteve në mënyrë ekonomike, efikase dhe efektive.

Tabela nr. 6: Rezultate nga sfera "Zhvillimi i burimeve njerëzore"

Zhvillimi i burimeve njerëzore (planifikimi i punës dhe monitorimi i performancës nga rezultatet e arritura)	Viti 2023			2022	+/- 2023- 2022
	Niveli qendror	Niveli lokal	Gjithsej		

	87 shfrytëzues buxhetorë		55 shfrytëzues buxhetorë		142 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqi ndje
	Numri	%	Numri	%	Numri	%		
Ekzistojnë plane për trajnimin e të punësuarve lidhur me kryerjen e punës në fushëveprimin e tyre.	78	89,66	53	96,36	131	92,25	89,7	2,55
Mbahet evidencë/regjistër trajnimi veçmas për çdo punëtor	73	83,91	37	67,27	110	77,46	75,2	2,26
Të punësuarit i referohen trajnimit lidhur me menaxhimin dhe kontrollin financiar (duke përfshirë trajnime në sferën e planifikimit strategjik, përpilimit dhe hartimit të kërkesës buxhetore, menaxhimit të risqeve, furnizimit dhe lidhjes së marrëveshjeve, sistemeve kontabiliste, parregullsisve dhe mashtrimeve, etj.)	70	80,46	47	85,45	117	82,39	77,9	4,49
Në planet vjetore të punës së njësisë organizative caktohen detyra/aktivitete veçmas për çdo punëtor.	32	36,78	24	43,64	56	39,44	35,9	3,54

B. MENAXHIMI I RISQEVE

Në nivel qendror, rreth 71%⁶ e shfrytëzuesve buxhetorë kanë miratuar Strategjinë e menaxhimit të risqeve, 78% e shfrytëzuesve buxhetorë i dokumentojnë risqet gjatë punës në Regjistrin e Risqeve, ndërsa rreth 69% i dokumentojnë risqet në dokumentet e tyre të planifikimit.

Në nivel lokal, rreth 46%⁷ e shfrytëzuesve buxhetorë kanë miratuar Strategjinë e menaxhimit të risqeve, 42% e shfrytëzuesve buxhetorë i dokumentojnë risqet gjatë punës në Regjistrin e Risqeve, ndërsa rreth 53% i dokumentojnë risqet në dokumentet e tyre të planifikimit.

Edhe pse shumica e shfrytëzuesve buxhetorë kanë miratuar Strategjitë e menaxhimit të risqeve, shumica e tyre nuk përditësohen rregullisht.

Në vitin 2023, në nivel qendror, 60% e shfrytëzuesve buxhetorë kanë emëruar një person përgjegjës për koordinimin e procesit të menaxhimit të riskut në nivel institucional, ndërsa 36% e tyre kanë emëruar koordinatorë risku në njësitë organizative. Në nivel lokal, rreth 29% e komunave kanë emëruar një person përgjegjës për koordinimin e procesit të menaxhimit të riskut në nivel institucional dhe rreth 18% e tyre kanë emëruar koordinatorë risku në njësitë organizative.

Te shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, praktika e përcaktimit të risqeve për qëllimet strategjike, programore dhe operacionale, duke marrë parasysh faktorët më të rëndësishëm të brendshëm dhe të jashtëm, përkatësisht ndryshimet në mjedisin e brendshëm dhe të jashtëm të institucionit dhe institucioneve kompetente të tij, ende nuk është zhvilluar në mënyrë të mjaftueshme. Ata zakonisht fokusohen mbi vlerësimin e riskut në lidhje me harmonizimin (rregullsinë) e punës dhe më pak mbi risqet që ndikojnë mbi rezultatet e punës së

⁶ dhe ⁷ Nga evidenca e Njesisë Qendrore të Harmonizimit

tyre. Gjithashtu, ka mospërputhje ndërmjet risqeve të identifikuar në dokumentet e planifikimit të institucioneve dhe regjistrat e riskut. Prandaj, nevojitet që të përforcohet koordinimi ndërmjet njësive organizative të planifikimit strategjik dhe koordinatorëve të menaxhimit të riskut në institucione.

Duke ndjekur praktikat më të mira evropiane në përforcimin e procesit të menaxhimit të riskut, përveç mjeteve metodologjike të përgatitura nga Njësia Qendrore e Harmonizimit, paraqitet nevoja që procesi i menaxhimit të riskut të rregullohet me akt të brendshëm/procedurë të brendshme në çdo institucion, me ç'rast do të përcaktohet e tërë procedura gjatë procesit në fjalë, si dhe roli i të gjitha pjesëmarrësve gjatë këtij procesi, sipas specifikave gjatë funksionimit të institucionit.

Sipas të dhënave të Njesisë Qendrore të Harmonizimit, numri i institucioneve në sektorin publik që identifikojnë risqet e korrupsionit dhe mashtrimit gjatë punës së tyre është ende i vogël.

Nevojitet përmirësimi i dokumentimit të risqeve në Regjistrin e Risqeve, ku do të përfshihen edhe risqet e korrupsionit, si dhe sistemi i raportimit për risqet e identifikuar dhe realizimin e masave për reduktimin e tyre në mënyrë që personi përgjegjës i institucionit të marrë informacione në kohë për risqet më të theksuara në kuadër të institucionit dhe institucioneve kompetente të tij⁸.

(Shtojca 2. Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë miratuar Strategji për menaxhimin e risqeve)

(Shtojca 3. Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë hartuar Regjistër të Risqeve)

Tabela nr.7: Rezultatet e “Menaxhimit të risqeve”

Menaxhimi i risqeve	Viti 2023						2022	+/- 2023- 2022
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej			
	87 shfrytëzues buxhetorë		55 shfrytëzues buxhetorë		142 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numri	%	Numri	%	Numri	%		
Përcaktohen risqet të cilat mund të ndikojnë në realizimin e:								
a) qëllimet strategjike	68	78,16	35	63,6 4	103	72, 53	69,7	2,83

⁸ Vetëm rreth 14% e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror marrin informacion për risqet më të theksuara nga organet në kuadër dhe shfrytëzuesve buxhetorë të linjës së dytë. Kjo përqindje është më e lartë në nivel lokal dhe arrin në 36%.

b) qëllimet e programit / projektit / aktivitetit	65	74,71	36	65,4 5	101	71, 13	66,2	4,93
c) qëllimet e përfshira në programin vjetor të punës	60	68,97	34	61,8 2	94	66, 20	62,1	4,1
Risqet janë evidentuar në formë të shkruar në:								
a) dokumentet e planifikimit (dokumentet strategjike / plani i programit të zhvillimit/planet vjetore të punës)	60	68,97	29	52,7 3	89	62, 68	56,6	6,08
b) Regjistrin e Risqeve, të përcaktuara në përputhje me udhëzimet për zhvillimin e procesit të menaxhimit të risqeve të shfrytëzuesit buxhetorë	68	78,16	23	41,8 2	91	64, 08	60,7	3,38
Për përcaktimin e risqeve vlerësohet probabiliteti dhe ndikimi i tyre	68	78,16	32	58,1 8	100	70, 42	66,9	3,52
Është krijuar sistem për raportimin e risqeve më të theksuara	54	62,07	18	32,7 3	72	50, 70	47,6	3,1
Ekziston person përgjegjës për koordinimin e krijimit të procesit për menaxhimin e risqeve	52	59,77	16	29,0 9	68	47, 89	44,1	3,79
Ekziston koordinatori i emëruar për risqet sipas njësive organizative	31	35,63	10	18,1 8	41	28, 87	27,6	1,27
Shfrytëzuesit buxhetorë në kuadër të buxhetit njoftojnë për risqet kryesore	12	13,79	20	36,3 6	32	22, 53	20	2,53

C.KONTROLLI

Shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal për një numër më të madh të proceseve të rëndësishme të punës⁹ kanë miratuar rregulla të shkruara, përkatësisht akte të brendshme (udhëzime dhe instruksione) të cilat në bazë të ligjeve dhe dispozitve të tjera, më detajisht rregullohen rregulloret e të vepruarit, definojnë pjesëmarrësit, autorizimet dhe përgjegjësitë e tyre, aktivitetet e kontrolluara, duke përfshirë kontrollet e mëparshme dhe ato shtesë dhe përcaktojnë formularë.

Procedurat u janë vënë në dispozicion udhëheqësve dhe të punësuarve ku në pjesën më të madhe të institucioneve janë përditësuar, në varësi të ndryshimeve ligjore dhe dispozitave të tjera në të cilat bazohen, nga ndryshimet në punën e institucionit dhe institucioneve kompetente, si dhe nga rezultatet e vlerësimeve të jashtme të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

Është ende e ulët përqindja procedurave të brendshme të shkruara që përmbajnë udhëzime për mënyrën e bashkëpunimit dhe aktivitetet për shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë, po ashtu ka pak njohuri se në çfarë mase shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë i kanë rregulluar aktivitetet e kontrollit në proceset e përgatitjes dhe realizimit të planeve dhe buxheteve financiare, prokurimeve dhe marrëveshjeve, menaxhimit të pronave etj.

Në pjesën më të madhe të institucioneve (76%) zbatohet parimi i “ndarjes së detyrimeve” në mënyrë të tillë që asnjë individ të mos jetë njëkohësisht përgjegjës për iniciimin, aprovimin dhe regjistrimin e transaksioneve, pagesën, harmonizimin dhe shqyrtimin e raporteve.

Në rastet kur nuk mundet të merret parasysh parimi i “ndarjes së detyrimeve”, për shkak të numrit të kufizuar të të punësuarve, udhëheqësit përcaktojnë masa të tjera për të ulur ekspozimin ndaj riskut që një person të jetë në gjendje të bëjë dhe të fshehtë gabime, parregullsi dhe mashtrime gjatë kryerjes së detyrimeve të tij.

Tabela nr.8: Rezultatet nga sfera e kontrollit

KONTROLLI	Viti 2023						2022	+/- 2023- 2022
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej			
	87 shfrytëzues buxhetorë		55 shfrytëzues buxhetorë		142 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqi ndje
	Numri	%	Numri	%	Numri	%		
Ekzistojnë procedura të brendshme të shkruara (rregullore, udhëzime, instruksione) të cilat si vazhdimësi e dispozitave rregullojnë më detajisht proceset e mëposhtme:								
a) procesi i përgatitjes dhe realizimi i planit strategjik	46	52,87	25	45,45	71	50	44,1	5,9
b) procesi i përgatitjes dhe realizimit të kërkesës së buxhetit/propozimit të buxhetit	67	77,01	47	85,45	114	80,28	73,1	7,18
c) procesi i evidentimit të ngjarjeve dhe transaksioneve afariste	67	77,01	36	65,45	103	72,53	66,9	5,63
ç) procesi i prokurimeve dhe marrëveshjeve	74	85,06	43	78,18	117	82,39	77,2	5,19
d) proces i menaxhimit të pronave – mjete materiale dhe jomateriale	53	60,92	28	50,91	81	57,04	53,8	3,24

⁹ Proceset e lidhura me planifikimin, programimin, realizimin e buxhetit, përkatësisht planin financiar, prokurimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve, evidentimin e ngjarjeve dhe transaksioneve të punës, menaxhimin e pronës (material dhe jomaterial), menaxhimin e projekteve, pagesën e të hyrave vetnake, kthimin e shpenzimeve të pajustificuara dhe mjeteve financiare të paguara gabimisht.

dh) procesi i arkëtimit të të hyrave vetnake	22	25,29	34	61,82	56	39,44	37,9	1,54
e) procesi i kthimit të mjeteve të shpenzuara në mënyrë të pajustificueshme ose të paguara gabimisht	35	40,23	31	56,36	66	46,48	44,1	2,38
Procedurat e brendshme përditësohen	72	82,76	39	70,91	111	78,17	75,2	2,98
Është siguruar ndryshimi i parimit të ndarjes së detyrimeve në përputhje me ligjin dhe standardet, përkatësisht i njëjti person të mos jetë përgjegjës për miratimin, realizimin, kontabilitetin dhe kontrollin	69	79,31	39	70,91	108	76,06	71,7	4,36
Zbatohen kontrole shtesë për shpenzime specifike të mjeteve të paguara buxhetore. (P.sh. kontrole në terren për subvencionet e paguara, dotacionet, ndihmat, kompensimet e ndryshme, mjetet buxhetore të transferuara te shfrytëzuesit e fundit etj.)	52	59,77	35	63,64	87	61,27	57,2	4,07
Procedura për zbatimin e kontrollit shtesë është rregulluar përmes procedurave të shkruara	38	43,68	11	20,00	49	34,51	33,1	1,41
Procedura për zbatimin e kontrollit shtesë për shpenzime specifike të mjeteve të paguara buxhetore është:								
a) pjesë e punës së rregullt të njësive organizative në institucionin përgjegjës për të	55	63,22	31	56,36	86	60,56	59,3	1,26
detyra ad hoc në rastet kur shfaqet nevoja për kontroll shtesë (p.sh. në rastin e raportimeve anonime për parregullsi të mundshme gjatë shfrytëzimit të mjeteve buxhetore)	47	54,02	28	50,91	75	52,82	52,4	0,42
Procedurat e brendshme të shkruara që kanë të bëjnë me përgatitjen dhe realizimin e planeve strategjike, përgatitjen dhe zbatimin e planit/buxhetit financiar, prokurimet dhe marrëveshjet, kontrollet shtesë etj, përfshijnë udhëzime për mënyrën e bashkëpunimit dhe aktivitetet për shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë	10	11,49	21	38,18	31	21,83	21,4	0,43
Ekzistojnë informacione se deri në çfarë mase shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë kanë rregulluar aktivitetet e kontrollit në proceset e përgatitjes dhe realizimit të planeve/buxheteve financiare, prokurimeve dhe marrëveshjeve, menaxhimit të pronave etj.	4	4,60	17	30,91	21	14,79	13,8	0,99

Ç. INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI

Analiza e të dhënave të marra nga RFV-ja në lidhje me informacionin dhe komunikimin e vendosur, tregon se shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal, në përgjithësi kanë sistem të brendshëm raportimi me të cilin sigurohen të dhëna dhe informacione në kohë, të sakta dhe të plota, si dhe shkëmbim të tyre ndërmjet njësive organizative të brendshme për nevojat e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, përkatësisht planit financiar, zbatim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve, monitorim të arritjes së qëllimeve të punëve dhe mjeteve financiare të shpenzuara.

Te pjesa më e madhe e shfrytëzuesve buxhetorë ende nuk është krijuar sistemi i brendshëm automatik i raportimit me të cilin sigurohen të dhëna dhe informacione në kohë, të sakta dhe të plota, si dhe shkëmbim të tyre ndërmjet njësive organizative të brendshme për nevojat e planifikimit dhe realizimit të buxhetit, zbatim të programeve, projekteve dhe aktiviteteve, monitorim të arritjes së qëllimeve të punëve dhe mjeteve financiare të shpenzuara.

Është definuar procesi i menaxhimit të dokumenteve dhe ruajtja e tyre në përputhje me kornizën juridike dhe aktet e brendshme, por nuk janë zhvilluar sisteme që do të mundësojë shkëmbimin e informacioneve ndërmjet institucioneve dhe institucioneve kompetente.

Tabela nr.9: Rezultatet nga sfera: "Informacioni dhe komunikimi"

INFORMACIONI DHE KOMUNIKIMI	Viti 2023			2022	+/- 2023- 2022
	Niveli qendror	Niveli lokal	Gjithsej		
	87 shfrytëzues buxhetorë	55 shfrytëzues buxhetorë	142 shfrytëzues buxhetorë	%	pikë përqind je

	Numri	%	Numri	%	Numri	%		
Definohen linjat e përcaktuara të raportimit për arritjen e qëllimeve strategjike të përfshira në dokumentet strategjike	56	64,37	24	43,64	80	56,34	54,5	1,84
Vendosja e sistemit për raportimin e realizimeve e programeve / projekteve	64	73,56	44	80	108	76,06	71	5,06
Vendosja e sistemit të rregullt të monitorimit dhe analizës së realizimit të planit / buxhetit financiar	82	94,25	53	96,36	135	95,07	90,3	4,77
Njësitë organizative marrin pjesë në përgatitjen e planit/buxhetit financiar	74	85,06	55	100	129	90,84	84,8	6,04
Njësitë organizative marrin informacione për mjetet e aprovuara financiare për zbatimin e programeve / projekteve / aktiviteteve për të cilat ata janë kompetentë	71	81,61	53	96,36	124	87,32	82,8	4,52
Për nevojën e monitorimit të zbatimit të planit / buxhetit financiar është përpiluar më detajisht klasifikimi ekonomik nga ai i përcaktuar në Rregulloren e planit të kontabilitetit për buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetorë, përkatësisht nëse është hapur analitika e planit të kontabilitetit	61	70,11	40	72,73	101	71,13	67,6	3,53
Sistemet e kontabilitetit mundësojnë monitorimin e shpenzimeve / të hyrave mbi:								
a) programet	74	85,06	54	98,18	128	90,14	86,2	3,94
b) projektet	50	57,47	46	83,64	96	67,61	64,1	3,5
c) aktivitetet	46	52,87	40	72,73	86	60,56	59,3	1,26
ç) njësitë organizative	46	52,87	36	65,45	82	57,75	55,2	2,55
A keni evidencë të centralizuar të të gjitha marrëveshjeve të nënshkuara dhe detyrimeve kontraktuale dhe a mbështetet nga sistemi i informacionit	63	72,41	39	70,91	102	71,83	68,3	3,53
Krahas raporteve financiare të përcaktuara (bilanci i gjendjes, bilanci i të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe bilanci i konsoliduar) ka edhe raporte të brendshme shtesë për nevojat e menaxhimit financiar (si psh. raportet për detyrimet e papaguara sipas programeve / projekteve / njësive organizative, raporteve të dakorduara, por që janë ende detyrime të pafaturuara, raportet për rezultatet e arritura të programeve / projekteve etj.)	69	79,31	42	76,36	111	78,17	75,2	2,98
Sistemet e punës (financat, prokurimet dhe marrëveshjet, evidenca materiale, kuadrot etj.) në pjesën më të madhe të rrejtit mbështeten nga teknologjia informatike (sistemi i TI-së)	72	82,76	48	87,27	120	84,51	81,4	3,11
Sistemet e IT-së të cilat mbështesin proceset e caktuara janë të integruara njëri me tjetrin	49	56,32	31	56,36	80	56,34	53,1	3,24
Proceset kryesore të punës që zbatohen në kuadër të njësive organizative janë të dokumentuara, përkatësisht nëse procedurat janë të definuara qartë, detyrat e pjesëmarrësve individualë, autorizimet dhe përgjegjësitë (si për shembull, nëse ekzistojnë udhëzime të brendshme, indikacione, rregullore, nëse janë përgatitur harta / libra të proceseve të punës etj.)	70	80,46	35	63,64	105	73,94	69,7	4,24
Shfrytëzuesët buxhetorë të linjës së dytë përgatisin edhe raporte të tjera, përveç raporteve financiare të përcaktuara, që i dorëzojnë te shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë *	9	10,34	19	34,55	28	19,72	20	-0,28
Është vendosur lidhje informatike me shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë (si psh, përmes Sistemit të Thesarit etj.)	13	14,94	39	70,91	52	36,62	35,2	1,42

D. MONITORIMI DHE VLERËSIMI I SISTEMIT

Analiza e të dhënave të marra në RFV në lidhje me monitorimin dhe vlerësimin e sistemit, tregon se shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal kryesisht zbatojnë: monitorimin e vazhdueshëm, vetëvlerësimin dhe revizionin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe procedurat të cilat sigurojnë që aktet e brendshme të zbatohen në praktikë dhe të përditësohen.

Në periudhën e ardhshme është e nevojshme të zhvillohen sisteme përkatëse për monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë (me implementimin e Propozimit të ligjit të ri për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik, pritet që këto kushte të përmirësohen dukshëm)

Tabela nr.10: Rezultatet nga “Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit”

Monitorimi dhe vlerësimi i sistemit	Viti 2023						2022	+/- 2023- 2022
	Niveli qendror		Niveli lokal		Gjithsej			
	87 shfrytëzues buxhetorë		55 shfrytëzues buxhetorë		142 shfrytëzues buxhetorë		%	pikë përqindje
	Numri	%	Numri	%	Numri	%		
Udhëheqësit e lartë kanë vendosur sistem raportimi që iu mundëson atyre të marrin raporte për funksionimin e sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar, për të cilët ata janë përgjegjës	57	65,52	31	56,36	88	61.97	59,3	2,67
Procedurat e vendosura që sigurojnë akte të brendshme (rregullore, udhëzime, instruksione etj.) të zbatohen në praktikë dhe të përditësohen	66	75,86	35	63,64	101	71.13	67,6	3,53
Zbatohen rekomandimet e revizorëve të brendshëm	72	82,76	50	90,91	122	85,91	81,4	4,51
rekomandimet e revizionit të brendshëm në përputhje me planet aksionale për zbatimin e rekomandimeve	52	59,77	44	80	96	67.6	64,8	2,8
Ekzistojnë sisteme të përcaktuara për raportimin e vendosur nga shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë që sigurojnë monitorimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar të shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së dytë	8	9,20	26	47,27	34	23.94	23,4	0,54

3. RAPORTI I REVIZIONEVE TË REALIZUARA DHE AKTIVITETET E REVIZIONIT TË BRENDSHËM PËR VITIN 2023

3.1 GJENDJA E REVIZIONIT TË BRENDSHËM SIPAS EVIDENCËS SË NJËSISË QENDRORE TË HARMONIZIMIT

3.1.1 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm te subjektet e sektorit publik në nivel qendror dhe lokal

Në përputhje me evidencën e Njesisë Qendrore të Harmonizimit deri më datën 31.12.2023, te 110 subjekte të sektorit publik në nivel qendror është vendosur funksioni i revizionit të brendshëm, ku janë punësuar 118 revizorë të brendshëm, nga të cilët 37 (rreth 34%) janë persona udhëheqës. Në vitin 2023, krahasuar me vitin paraprak, në nivel qendror, numri i revizorëve të brendshëm është rritur me një person.

Te subjektet e sektorit publik në nivel lokal deri më datën 31.12.2023, te 84 subjekte të sektorit publik në nivel qendror është vendosur funksioni i revizionit të brendshëm, ku janë punësuar 67 revizorë të brendshëm, nga të cilët 18 (rreth 21%) janë persona udhëheqës. Në vitin 2023, krahasuar me vitin paraprak në nivel qendror, numri i revizorëve të brendshëm është ulur për dy, prej të cilëve njëri është person udhëheqës.

Nga e lartëpërmendura mund të konstatohet se në vitin 2023, krahasuar me vitin paraprak në nivel qendror dhe lokal, numri i revizorëve të brendshëm është ulur për një person (0.5%), ndërsa numri i udhëheqësve mbetet i njëjtë për arsye sepse ky numër është rritur në nivel qendror, ndërsa në nivel lokal është ulur për një person.

Në periudhën e kaluar është hasur tendenca drejt uljes së numrit të revizorëve dhe udhëheqësve të brendshëm, për shkak të vjetërsimit të moshës në strukturën e tyre, por edhe për shkak të luhatjes së revizorëve të brendshëm në sektorin privat, ku ka të ardhura më të larta, si dhe për shkak të migrimit jashtë vendit.

3.1.2 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm te shfrytëzuesit buxhetorë në nivel qendror dhe lokal

Nga 65 njësitë e themeluara për revizionin e brendshëm të shfrytëzuesve buxhetorë të linjës së parë, 26 (40%) nuk janë të ekipuar, 21 (32.3%) janë të ekipuar me nga një revizor të brendshëm, ndërsa 18 (27.7%) me dy ose më shumë revizorë. 19 shfrytëzuesit e tjerë buxhetorë në nivel qendror që nuk kanë themeluar revizion të brendshëm, janë subjekte të vogla që kanë buxhet nën 50 milionë denarë dhe nuk kanë detyrim ligjor të themelojnë njësitë e tyre për revizion të brendshëm (4 komisione, 3 agjenci, 9 inspektorate dhe 3 organe të tjera).

Nga 77 shfrytëzuesit buxhetorë në nivel lokal që kanë themeluar funksion të revizionit të brendshëm, 58 (rreth 75.3%) kanë themeluar Njësinë e Revizionit të Brendshëm, 9 kanë Njësinë e tyre të Revizionit të Brendshëm dhe njëkohsisht kanë lidhur marrëveshje për kryerjen e revizionit të brendshëm (rreth 11.6%), ndërsa 10 kanë lidhur vetëm marrëveshje për kryerjen e revizionit të brendshëm (1.3%). Nga 67 njësitë e themeluara të revizionit të brendshëm, 28 (41.8%) nuk janë të ekipuara, 28 (41.8%) janë të ekipuara me nga një revizor të brendshëm, ndërsa 11 (16.4%) janë me dy ose më shumë revizorë. 4 komunat e tjera (Nagoriçani i Vjetër, Studeniçani, Haraçina dhe Dollneni) nuk kanë themeluar revizion të brendshëm.

Nga të dhënat e paraqitura më sipër tregohet se ka përqindje të lartë të njësive të themeluara të revizionit të brendshëm të cilat nuk janë ekipuar, ose janë ekipuar me nga një revizor të brendshëm, (në nivel qendror rreth 70.6%, ndërsa në nivel lokal 82%). Me qëllim që të plotësohen kriteret minimale prej dy revizorësh, në secilën njësi të revizionit të brendshëm është e nevojshme që në periudhën e ardhshme të ndërmerren aktivitetet për ekipimin e njësive të revizionit të brendshëm.

Tabela nr.11: Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë të linjës së parë, fondeve dhe komunave që kanë themeluar revizion të brendshëm

Shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë, fondet dhe komunat	Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve buxhetorë (shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë, fondet dhe komunat)	Numri i shfrytëzuesve buxhetorë të linjës së parë, fondeve dhe komunave të cilat kanë themeluar revizion të brendshëm deri më datën 31.12.2023				% e shfrytëzuesve buxhetorë që deri më datën 31.12.2023 kanë vendosur revizion të brendshëm
		Njësia e Revizionit të Brendshëm	Marrëveshje	Njësia e Revizionit të Brendshëm dhe Marrëveshja	Gjithsej	
Niveli qendror	98	64	14	1	79	80.6 %
Niveli lokal	81	37	10	9	56	69 %
Gjithsej	179	112	26	10	151	%

Revizioni i brendshëm është vendosur edhe në 38¹⁰ shfrytëzues buxhetorë të themeluar me ligj, bartës të autorizimeve publike dhe njësi shfrytëzuese (nga të cilat 31 në nivel qendror dhe 7 në nivel lokal).

Tabela nr.12 : Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë të themeluar me ligj të cilëve u është dhënë autorizim publik dhe njësi të shfrytëzuesve që kanë themeluar revizion të brendshëm

Shfrytëzuesit buxhetorë të themeluar me ligj të cilëve u është dhënë autorizim publik dhe njësitë shfrytëzuese	Numri i përgjithshëm i shfrytëzuesve buxhetorë të themeluar me ligj të cilëve u është dhënë autorizim publik dhe njësi shfrytëzuese për të cilat Njësia e Qendrës së Harmonizimit (NJQH) ka evidencë	Numri i shfrytëzuesve buxhetorë të themeluar me ligj të cilëve u është dhënë autorizim publik dhe njësi shfrytëzuese të cilat kanë themeluar revizion të brendshëm deri më datën 31.12.2023				% e shfrytëzuesve buxhetorë të cilët kanë vendosur revizion të brendshëm deri më datë 31.12.2023
		Njësia e Revizionit të Brendshëm	Marrëveshje	Nuk ka Njësi të Revizionit të Brendshëm ka revizor brendshëm	Gjithsej	
Niveli qendror	31	27	0	4	31	100
Niveli lokal	7	7	0	0	7	100
Gjithsej	38	34	0	4	38	100

3.1.3 Organizimi dhe ekipimi i revizionit të brendshëm te ministrinë

Nga gjithsej 20¹¹ ministri, në 2 ministri nuk ka të punësuar në njësitë e revizionit të brendshëm, në 6 ministri ka nga një të punësuar dhe në 8 ministri nuk ka udhëheqës të Njesisë së Revizionit të Brendshëm, për katër ministrinë e reformuara, NJQH-ja nuk ka të dhëna.

Kjo tregon se nuk janë plotësuar kushtet për funksionimin e njësi të revizionit të brendshëm nëpër ministri.

Në 12 ministri, njësitë e revizionit të brendshëm janë të organizuara si departamente.

¹⁰Për të cilët NJQH-ja ka evidencë

¹¹ Четири министерства се ново формирани (Министерство за европски прашања, Министерство за енергетика, рударство и минерални сировини, Министерство за јавна администрација и Министерство за спорт

Katër ministri janë krijuar rishtazi (Ministria e Çështjeve Evropiane, Ministria e Enerjetikës, Minierave dhe Burimeve Minerale, Ministria e Administratës Publike dhe Ministria e Sportit)

Duke pasur parasysh se me ligjin e ri, respektivisht Ligjin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik, ministritë do ta kenë rolin e shfrytëzuesve buxhetorë të cilët do të duhet të kryejnë revizione të brendshme në organet e tyre përbërëse, shfrytëzuesit e linjës së dytë buxhetore dhe ndërmarrjet publike dhe shoqëritë aksionare në pronësi shtetërore të tyre, nevojitet që të ndërmerren masa urgjente për riorganizimin e njësive të revizionit të brendshëm dhe ekipimin e tyre.

Tabela nr.13: Organizimi dhe ekipimi i NJRB në ministri¹²

Nr. rendor	Institucioni	Numri i të punësuarve në NJRB	Udhëheqësi i emëruar (po/jo)	Forma e organizimit në NJRB
	Ministria e Financave	5	Po	Sektor
	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave	5	Po (me autorizim)	Sektor
	Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë	5	Po	Sektor
	Ministria e Mbrojtjes	7	Po	Sektor
	Ministria e Punëve të Brendshme	2	Po	Njësi
	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme	1	Jo	Njësi
	Ministria e Shëndetësisë	1	Po	Njësi
	Ministria e Kulturës dhe Turizmit	0	Jo	Njësi
	Ministria e Drejtësisë	2	Jo	Njësi
	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe e Planifikimit Hapësinor	2	Po	Njësi
	Ministria e Transportit dhe e Lidhjeve	2	Jo	Njësi
	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës	1	Jo	Njësi
	Ministria e Vetëqeverisjes Lokale	1 (në pezullim)	Po	Njësi
	Ministria e Ekonomisë dhe Punës	1	Jo	Njësi
	Ministria e Transformimit Dixhital	0	Jo	Njësi
	Ministria e Marëdhënieve ndërmjet Bashkësive	1	Jo	Njësi
	Ministria e Administratës Publike			Nuk ka të dhëna
	Ministria e Sportit			Nuk ka të dhëna
	Ministria e Çështjeve Evropiane			Nuk ka të dhëna
	Ministria e Energjetikës, Minierave dhe Burimeve Minerale			Nuk ka të dhëna

¹² Gjendja deri në muajin qershor të vitit 2024

3.2 GJENDJA E REVIZIONIT TË BRENDSHËM SIPAS RAPORTEVE VJETORE TË DORËZUARA VJETORE PËR VITIN 2023

Detyrimi për dorëzimin e Raportit për revizionet e kryera dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm u është ngarkuar 178 shfrytëzuesve buxhetorë, nga të cilët 97 në nivel qendror dhe 81 në nivel lokal.

Nga gjithsej 178 shfrytëzues buxhetorë, 63.4% përkatësisht 113¹³ kanë dorëzuar raport, ndërsa 36.5% përkatësisht 65¹⁴ subjekte nuk kanë dorëzuar.

Krahas shfrytëzuesve buxhetorë, raport kanë dorëzuar edhe 3 subjekte¹⁵ nga sektori publik në nivel qendror edhe pse nuk janë të obliguar ta dorëzojnë atë. Me këtë, numri i raporteve të dorëzuara në nivel qendror është 68.

(Shtojca 4. Pasqyra e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë dorëzuar raporte për revizionet e realizuara dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm).

3.2.1 Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel qendror sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2023

Në nivel qendror, gjithsej 68 shfrytëzues buxhetorë kanë dorëzuar raporte, nga të cilët 65 janë shfrytëzues buxhetorë të linjës së parë, 3 janë shfrytëzues buxhetorë të linjës së dytë¹⁶. Nga 68 shfrytëzues buxhetor në nivel qendror që kanë dorëzuar raporte, 43 kanë krijuar Njësi të Revizionit të Brendshëm në të cilat janë sistemuar 197 vende pune, ku 72 prej tyre janë plotësuar, respektivisht vetëm rreth 36.5%.

Nga shfrytëzuesit buxhetorë që kanë dorëzuar raport, në 13 shfrytëzues buxhetorë në nivel qendror, revizioni i brendshëm është kryer nga një subjekt tjetër i sektorit publik sipas marrëveshjes së lidhur ndërmjet udhëheqësve të dy subjekteve, ndërsa në 2 shfrytëzues buxhetorë, revizioni i brendshëm është kryer nga ana e revizorëve të brendshëm të regjistruar në Regjistrin e Revizorëve të Brendshëm të Autorizuar sipas marrëveshjes së lidhur.

Sipas planeve vjetore për vitin 2023, në nivel qendror është planifikuar të kryhen 156 revizione (në vitin 2022, 163 revizione), nga të cilat 145 janë planifikuar fillimisht dhe 11 revizione shtesë ad-hoc me kërkesë të udhëheqësve.

Nga gjithsej 156 revizione të planifikuara, janë kryer 128 revizione¹⁷, respektivisht 83 %¹⁸, që paraqet rritje të realizimit të revizioneve të planifikuara prej rreth 0.2 pikë përqindjeje.

¹³ 65 nga niveli qendror dhe 48 nga niveli lokal

¹⁴ 32 në nivel qendror dhe 33 në nivel lokal

¹⁵ Fondi i Sigurimit të Depozitave, Drejtoria e Zbulimit Financiare dhe Byroja e Prokurimeve Publike


¹⁶ Fondi i Sigurimit të Depozitave, Drejtoria e Zbulimit Financiare dhe Byroja e Prokurimeve Publike

¹⁷ 135 revizione në vitin 2022

Në vitin 2023 janë planifikuar fillimisht 22 revizione në lidhje me programet e BE-së¹⁹, nga të cilat janë kryer 19²⁰, përkatësisht 86%²¹ që paraqet ulje të realizimit të revizioneve të planifikuara fillimisht me një pikë përqindje. Nga 19 revizione të kryera në lidhje me programet e BE-së, vetëm një revizion është revizion ad hoc me kërkesë të udhëheqësisë.

Sipas viteve, revizionet e planifikuara dhe të kryera janë si në vijim:

Revizionet e planifikuara dhe të kryera



Nga 128 revizione të kryera:

- 40.6% (52) janë revizione sistematike,
- 32% (41) janë revizione të rregullshmërisë,
- 7% (9) janë revizione për monitorim të rekomandimeve,
- 15.7% (20) janë revizione të kombinuara,
- 0.8% (1) revizione IT
- 0.8% (1) revizioni i performances dhe
- 3.1% (4) janë revizione financiare.
-

Në vitin 2023, nga 2507 rekomandime (nga viti paraprak dhe ai aktual me maturim në vitin 2023), janë realizuar 1567 rekomandime, përkatësisht 62.5% e rekomandimeve (në vitin 2022, 66.5)²² që paraqet rënie të realizimit të rekomandimeve të dhëna me 4 pikë përqindje.

Në vitin 2023 janë dhënë 577 rekomandime për revizionet e kryera në nivel qendror, prej të cilave 459 janë në afat të realizimit në vitin 2023, ndërsa janë realizuar 264 të tilla.

¹⁸ 82.8% në vitin 2022

¹⁹ 18 në vitin 2022

²⁰ 18 në vitin 2022

²¹ 83% në vitin 2022

²² "Llogaritur duke zbatuar treguesin "passport" - "Përqindja e rekomandimeve të zbatuara të revizionit të brendshëm"

Nga 2048 rekomandime nga raportet e viteve paraprake në vitin 2023, janë realizuar 1303 rekomandime²³.

Njësitë e revizionit të brendshëm në nivel qendror në vitin 2023 kanë kryer 128 revizione (135 në vitin 2022) për të cilat kanë shpenzuar 10.582 ditë të revizioneve (10.248 në vitin 2022), mesatarisht 83 ditë të revizioneve, që paraqet rritje të numrit mesatar të ditëve për një revizion për 7 ditë.

Ditët e nevojshme të revizionit për një revizion sipas viteve



3.2.2 Gjendja e revizionit të brendshëm në nivel lokal sipas raporteve të dorëzuara vjetore për vitin 2023

Nga 81 subjekte në nivel lokal që janë të detyruara të dorëzojnë raporte për revizionet e kryera dhe aktivitetet e revizionit të brendshëm, 48 komuna kanë dorëzuar raporte (42 në vitin 2022).

Nga 48 subjekte në nivel lokal që kanë dorëzuar raporte, 36 kanë krijuar Njësi të Revizionit të Brendshëm, në të cilat janë sistemuar 98 vende pune, ndërsa janë plotësuar 58 vende pune, respektivisht rreth 59%, 11 kanë lidhur marrëveshje për kryerjen e revizionit të brendshëm me subjekt tjetër nga sektori publik dhe një subjekt ka lidhur marrëveshje për kryerjen e revizionit të brendshëm me revizor të brendshëm të autorizuar në sektorin publik.

Sipas planeve vjetore për vitin 2023, në nivel lokal është planifikuar të kryhen 133²⁴ revizione, nga të cilat 126 janë planifikuar fillimisht dhe 7 revizione ad hoc me kërkesë të udhëheqësve, nga të cilat janë kryer 105 revizione²⁵ ose rreth 79 %²⁶.

²³ Për 193 rekomandime nga vitet paraprake dhe 111 nga viti 2023, afati i zbatimit ende nuk ka kaluar.

²⁴ 181 në vitin 2022

²⁵ 132 në vitin 2022

²⁶ 73% në vitin 2022

Në vitin 2023, edhe pse 14 komuna²⁷ raportuan se po shfrytëzonin mjete të BE-së, fillimisht u planifikuan dhe u kryen 2 revizione në lidhje me programet e BE-së dhe një revizion ad hoc, respektivisht gjithsej 3 revizione në lidhje me programet e BE-së.

Sipas viteve, revizionet e planifikuara dhe të kryera janë si në vijim:

Revizione të planifikuara dhe të kryera



Nga 105 revizione të kryera:

- rreth 15.2% (16) janë revizione sistematike,
- rreth 42.9% (45) janë revizione të rregullshmërisë,
- rreth 5.7% (6) janë revizione të performancës,
- rreth 13.3% (14) janë revizione financiare,
- rreth 6.7% (7) janë revizione për monitorim të rekomandimeve,
- rreth 16.2% (17) janë revizione të kombinuara.

Në vitin 2023, nga 1150 rekomandime (nga viti paraprak dhe ai aktual me afat maturimi në vitin 2023), janë realizuar 729 të tilla, përkatësisht 63.3% e rekomandimeve (63.3% në vitin 2022)²⁸.

Në vitin 2023 janë kryer 524 rekomandime për revizionet e kryera në nivel lokal, nga të cilat 356 janë me afat maturimi për realizim në vitin 2023 dhe janë realizuar 250 të tilla.

Nga 794 rekomandime nga raportet e viteve paraprake, 479 rekomandime²⁹ janë realizuar në vitin 2023.

Njësitë e revizionit të brendshëm në nivel lokal në vitin 2023 kanë kryer 105 revizione për të cilat kanë shpenzuar 4907 ditë të revizionit (6824 në vitin 2022), mesatarisht 47 ditë të revizionit (52 në vitin 2022)

²⁷ 13 në vitin 2022

²⁸ "Llogaritur duke zbatuar treguesin "passport" - "Përqindja e rekomandimeve të zbatuara të revizionit të brendshëm"

²⁹ Për 24 rekomandime nga vitet paraprake dhe 111 nga viti 2023, afati i zbatimit ende nuk ka kaluar.

Numri i ditëve të nevojshme të revizionit për një revizion sipas viteve është paraqitur në grafikët vijues:

Ditët e nevojshme të revizionit për një revizion sipas viteve



Progresi i arritur në revizionin e brendshëm në vitin 2023 në raport me vitin paraprak

NIVELI QENDROR	NIVELI LOKAL
<ul style="list-style-type: none"> • rritje e numrit të subjekteve që kanë dorëzuar raporte për 21.4% (nga 56 në 68); • rritje e numrit të subjekteve në nivel qendror që kanë dorëzuar raporte nga 56 në 65; • rritje e numrit të revizorëve nga 117 në 118; • rritje e numrit të rekomandimeve të zbatuara nga viti aktual, nga 255 në 264; • rritje e numrit të rekomandimeve të zbatuara nga vitet paraprake, nga 1073 në 1303; • rritje e numrit të revizioneve të planifikuara në lidhje me programet e BE-së, nga 18 në 22; • rritje e numrit të revizioneve të kryera lidhur me programet e BE-së, nga 18 në 19; • rritje e numrit të revizioneve të kombinuara të kryera, nga 12 në 20; • 4 revizione financiare të kryera, në lidhje me vitin 2022 ku nuk është zbatuar asnjë i tillë; 	<ul style="list-style-type: none"> • rritje e numrit të subjekteve që kanë dorëzuar raporte për 9.5% (nga 42 në 46); • rritje e numrit të revizioneve të kryera të performancës, nga 2 në 6; • rritje e numrit të revizioneve të kryera të njëpasnjëshme, nga 2 në 7; • rritje e përqindjes së revizioneve të kryera në raport me ato të planifikuara për 6 pikë përqindje; • rritje e përqindjes së rekomandimeve të zbatuara në raport me ato të dhëna për 2 pikë përqindje, përkatësisht nga 61.4% në 63.4%;

Mangësitë e përcaktuara lidhur me revizionin e brendshëm për vitin 2023 në raport me vitin paraprak

NIVELI QENDROR	NIVELI LOKAL
<ul style="list-style-type: none"> • ulje e numrit të revizioneve të planifikuara për 4.2% (nga 163 në 156); • ulje e numrit të revizioneve të kryera për 5.1% (nga 135 në 128); • ulje e numrit të rekomandimeve të dhëna për 8.7% (nga 633 në 577); • ulje e përqindjes së rekomandimeve të zbatuara në raport me numrin e rekomandimeve të dhëna për rreth 4 pikë përqindje, përkatësisht nga 66.5% në 62.5%; • ulje e numrit të revizioneve të kryera të performancës, nga 63 në 41; 	<ul style="list-style-type: none"> • ulje e numrit të revizorëve të brendshëm për 2.8% (nga 69 në 67); • ulje e numrit të udhëheqësve për 5.2% (nga 19 në 18); • ulje e numrit të revizioneve të planifikuara, nga 181 në 133, përkatësisht për 26.5%; • ulje e numrit të revizioneve të kryera, nga 132 në 105; • ulje e numrit të revizioneve të kryera lidhur me programet e BE-së nga 9 në 3 revizione; • ulje e numrit të revizioneve të kryera sistematike, nga 34 në 16, përkatësisht 53% pikë përqindje; • ulje e numrit të revizioneve të kryera të harmonizimit, nga 59 në

<ul style="list-style-type: none"> • ulje e numrit të revizioneve të kryera të njëpasnjëshme, nga 16 në 9; • rritja e numrit të përgjithshëm të ditëve të revizionit për revizionet e realizuara nga 10248 në vitin 2022, në 10582 në vitin 2023, përkatësisht 7 ditë revizioni mesatarisht për revizion, • në 4 subjekte të sektorit publik në nivel qendror³⁰, revizorët e brendshëm nuk kryejnë ekskluzivisht punë të revizionit të brendshëm. 	<ul style="list-style-type: none"> 45; • ulje e numrit të revizioneve të kryera financiare, nga 16 në 14; • ulje e numrit të revizioneve të kryera të kombinuara, nga 19 në 17; • ulje e numrit të rekomandimeve të dhëna në vitin paraprak dhe atë raportues, nga 2096 në 1150; • ulje e numrit të rekomandimeve të dhëna të zbatuara në revizionin paraprak dhe periudhën raportuese, nga 1287 në 729; • ulje e rekomandimeve të dhëna në periudhën raportuese, nga 746 në 524; • ulje e numrit të rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese, nga 350 në 250; • në 4 subjekte të sektorit publik në nivel lokal³¹, revizorët e brendshëm nuk kryejnë ekskluzivisht punë të revizionit të brendshëm.
---	--

4. NJËSIA QENDRORE E HARMONIZIMIT

4.1. Aktivitetet e realizuara të Njesisë Qendrore të Harmonizimit në vitin 2023

Në vitin 2023, Njësia Qendrore e Harmonizimit vazhdoi zbatimin e reformave në kontrollin e brendshëm financiar publik përmes aktiviteteve të mëposhtme:

- Koordinimi i vazhdueshëm i zhvillimit, vendosjes, zbatimit dhe mirëmbajtjes së Sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik nëpërmjet komunikimit dhe përkrahjes së drejtpërdrejtë të njësive të çështjeve financiare dhe njësive të revizionit të brendshëm të institucioneve në sektorin publik;
- Analiza e të gjithë dokumentacionit të përgatitur nga njësitë e çështjeve financiare dhe njësitë e revizionit të brendshëm sipas Ligjit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik;
- Implementimi i masave dhe aktiviteteve të theksuara në “Programin e menaxhimit të financave publike 2022-2025” - Shtylla 6 - Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik, prioritetet: Menaxhimi dhe kontrolli financiar si dhe Revizioni i brendshëm;
- Është përgatitur Raporti vjetor i funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2022, i cili është miratuar nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut më 29 gusht të vitit 2023.
- Përgatitja e mendimeve me kërkesë të Sekretariatit të Përgjithshëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, në lidhje me raportet përfundimtare të Entit Shtetëror të Revizionit, planet aksionale të përgatitura në bazë të këtyre raporteve dhe raportet për implementimin e planeve aksionale;
- Supervizioni i punës së Njesisë së Revizionit të Brendshëm në NQP - Shkup;
- Koordinimi për zbatimin e revizionit të brendshëm “ad hoc” të sistemit të menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm të strukturës IPA në Ndërmarrjen Publike të Infrastrukturës Hekurudhore “Hekurudhat e Republikës së Maqedonisë së Veriut”;
- Zbatimi i aktiviteteve për koordinimin dhe bashkëpunimin e Ministrisë së Financave nëpërmjet Njesisë Qendrore të Harmonizimit me Komisionin Shtetëror të Parandalimit të Korrupsionit, për zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve në lidhje me “Strategjinë nacionale të parandalimit të korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021 -2025”;

³⁰ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Ministria e Shëndetësisë, Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural dhe Drejtoria e Librave Amë

³¹ NJVL Manastir, Gostivar Bërvenicë dhe Shtip

- Njësia Qendrore e Harmonizimit është e përfshirë rregullisht dhe merr pjesë në takime dhe ngjarje të organizuara për parandalimin e korrupsionit dhe mashtrimit në sektorin publik;
- Njësia Qendrore e Harmonizimit merr pjesë në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm për Axiendën reformuese 2024-2027, që lidhet me Planin e rritjes për Ballkanin Perëndimor.

Në vitin 2023, Njësia Qendrore e Harmonizimit, në bashkëpunim me ekspertë të projektit tuining “Përforcimi i funksioneve të planifikimit të buxhetit, realizimit dhe kontrollit të brendshëm”, realizoi këto aktivitete:

- Është përgatitur Propozimi i rregullores për mënyrën e realizimit të detyrave në kompetencë të Njesisë së Çështjeve Financiare;
- Është përgatitur Propozimi i udhëzimit për kryerjen e kontrolleve të cilësisë së aktiviteteve të revizionit të brendshëm;
- Është përgatitur Propozimi i rregullores për zhvillimin e vazhdueshëm profesional të revizorëve të brendshëm;
- Zhvillimi/përmirësimi i aktiviteteve të kontrollit për parandalimin e krijimit të borxheve në të ardhmen në 5 institucione pilote (analizë e situatave, pyetësorë, intervista dhe rekomandime për përmirësim);
- Zhvillimi i llogaridhënies së decentralizuar drejtuese në 5 institucione pilote (analizë e rregulloreve aktualisht në fuqi lidhur me Sistemin e llogaridhënies drejtuese, pyetësor për institucionet pilote, intervista dhe rekomandime për përmirësim);
- Përmirësimi i menaxhimit të risqeve së paku në 5 institucione pilote (analiza e rregulloreve aktualisht të vlefshme lidhur me sistemin e menaxhimit të risqeve, pyetësor për institucionet pilote, intervista dhe rekomandime për përmirësim);
- Përmirësimi i Sistemit të informacioneve, komunikimit dhe monitorimit në 5 institucionet pilote (analizë e rregulloreve aktualisht në fuqi lidhur me Sistemin e informacioneve, komunikimit dhe monitorimit, pyetësor për institucionet pilote, intervista dhe rekomandime për përmirësim);
- Janë organizuar dy punëtori njëditore: “Menaxhimi dhe kontrolli financiar – implementimi praktik” (në nivel qendror dhe lokal);
- Është organizuar Konferenca koordinuese e Projektit tuining në Ministrinë e Financave të RMV-së - Rezultatet e arritura;
- Janë organizuar dy punëtori njëditore për revizorët e brendshëm në nivel qendror dhe lokal me temë “Kuptimi dhe përvoja praktike në procesin e revizionit të brendshëm të bazuar në risk”;
- Janë organizuar dy punëtori njëditore për të punësuarit e njësive të çështjeve financiare me temën “Njësia e Çështjeve Financiare - roli koordinues për zhvillimin e menaxhimit dhe kontrollit financiar, si dhe menaxhimi i riskut në entet e sektorit publik”;
- Janë organizuar dy punëtori njëditore për revizorët e brendshëm në nivel qendror dhe lokal me temën “Sistemi i sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë së revizionit të brendshëm (vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm)”;
- Është realizuar vizitë studimore në Ministrinë e Financave - Mbretëria e Holandës;
- Në tremujorin e tretë të vitit 2023 filloi koordinimi dhe zbatimi i tre kontrolleve pilote të cilësisë së Sistemit të menaxhimit dhe kontrollit financiar dhe tre kontrolleve pilote të cilësisë së punës së njësive të revizionit të brendshëm (në tre institucione pilote: Ministria e Financave, Agjencia e Kadastrës së Patundshmërive dhe Komuna e Velesit). Raportet përfundimtare nga kontrollet e realizuara të cilësisë janë lëshuar që në

tremujorin e dytë të vitit 2024, me ç'rast informacionet më të detajuara për kontrollet e realizuara pilote do të prezantohen me Raportin vjetor të funksionimit të Sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2023.

4.1.1. Aktivitetet e Njesisë Qendrore të Harmonizimit në lidhje me Kapitullin 32 – Kontrolli financiar

Në bazë të “Vendimit për krijimin e strukturës negociuese për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian” (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.200/2022 dhe nr.224/2022), “Vendimit për përcaktimin e institucioneve, përfaqësuesit e të cilave janë pjesë e grupeve të punës për përgatitjen e pozitave negociuese të negociatave për pjesëmarrjen e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian” (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 224/2022), si dhe konkluzioneve të seancës së 78-të të Qeverisë, mbajtur më datë 05.09.2022, Ministria e Financave, si institucion përgjegjës për Kreun 32 – Kontrolli Financiar, ka dorëzuar propozimin për Grupin e punës për Kreun 32 – Kontrolli Financiar (Klasterii 1 - Vlerat themelore) në Sekretariatit e Çështjeve Evropiane. Në pajtim me atë që u tha më sipër, udhëheqësi i Njesisë Qendrore të Harmonizimit është emëruar si drejtues i grupit të punës.

Ministria e Financave, nëpërmjet Njesisë Qendrore të Harmonizimit në pajtim me dispozitat e vendimeve të përmendura më sipër, ka rol kyç në koordinimin e përgjithshëm dhe përgatitjen e të gjitha materialeve për mbledhjen shpjeguese për kreun, skringun bilateral dhe përgatitjen e raporteve të progresit dhe të gjitha detyrimet e tjera që rezultojnë nga kreu dhe që janë me kërkesë të Komisionit Evropian.

Ministria e Financave, nëpërmjet Sekretariatit të Çështjeve Evropiane, i raporton rregullisht Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për statusin dhe realizimin e masave dhe aktiviteteve të kreut.

4.2. Raportime ndaj konkluzioneve të Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2022

Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, në mbledhjen e njëqind e tetëdhjetë e një të mbajtur më 29 gusht 2023, miratoi me konkluzione “Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2022”.

Me konkluzionin nr. 5, Ministria e Financave - Sektori i Harmonizimit Qendror i Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik, detyrohet që ta informojë Qeverinë me Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2023 për zbatimin të konkluzioneve nga “Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2022”. Sipas këtij konkluzioni, në këtë segment të raportit vjetor përfshihet edhe pasyqra e zbatimit të aktiviteteve të Raportit vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2022.

Me Konkluzionin Nr. 4: “Të gjitha ministrinë janë të obliguara, ndërsa u rekomandohet njësive të vetëqeverisjes lokale që të raportojnë në Ministrinë e Financave – Sektori i Harmonizimit Qendror të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik deri më datë 10.05.2024 për aktivitetet e ndërmarra sipas konkluzioneve”.

Nga 16 ministrinë që ishin përgjegjëse për konkluzionin, raportime për veprimet e ndërmarra ndaj konkluzioneve kanë dorëzuar 11, ndërsa pesë ministri nuk kanë dorëzuar fare raportim për veprimet e ndërmarra për asnjë nga konkluzionet, përkatësisht ministrinë e mëposhtme nuk kanë dorëzuar raportim: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës.

Nga 80 komuna dhe Qyteti i Shkupit që iu është rekomanduar të veprojnë sipas konkluzionit, 27 subjekte (26 komuna dhe Qyteti i Shkupit) kanë dorëzuar raportim për veprim sipas konkluzioneve, ndërsa 54 nuk kanë dorëzuar fare raportim për veprim sipas konkluzioneve.

Me Konkluzionin numër 1 “Ministria e Drejtësisë, Ministria e Transportit dhe Lidhjeve, Ministria e Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave, Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Vetëqeverisjes Lokale, Ministria e Kulturës, Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve Ndërmjet Bashkësive obligohen, ndërsa u rekomandohet njërive të vetëqeverisjes lokale deri më datë 31.12.2023 që ta miratojnë Kodin e tyre të etikës, i cili ndër të tjera do të përcaktojë mënyrën e veprimit me rastet e raportuara të sjelljes joetike, me ç’rast do të caktojë person përgjegjës të etikës dhe do të krijojë Komitetin e Etikës”.

Nga ministrinë përgjegjëse, asnjë ministri nuk ka raportuar se ka vepruar sipas konkluzionit, gjithashtu edhe në nivel lokal asnjë komunë nuk ka raportuar se ka vepruar sipas konkluzionit dhe se ka miratuar Kodin e Etikës, me ç’rast, ndër të tjera, do të përcaktohet mënyra e trajtimit të rasteve të raportuara të sjelljes joetike, me ç’rast do të caktojë person përgjegjës të etikës dhe do të krijojë Komitetin e Etikës.

Me Konkluzionin numër 2: “Deri më datë 30.04.2024, ministrinë obligohen që të realizojnë revizion të brendshëm të procesit të menaxhimit të riskut, ndërsa u rekomandohet njërive të vetëqeverisjes lokale që të veprojnë në këtë drejtim”. Njëkohësisht, Ministria e Financave - Sektori i Harmonizimit Qendror të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik është i obliguar që deri më datë 31.12.2023, t’u japë ministrive dhe njërive të vetëqeverisjes lokale udhëzime për realizimin e revizionit të brendshëm të procesit të menaxhimit të riskut”.

Ministria e Financave - Sektori i Harmonizimit Qendror të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik deri më datë 31.12.2023 ka përgatitur udhëzime për realizimin e revizionit të brendshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

Nga raportet e dorëzuara dhe veprimet e ndërmarra ndaj udhëzimeve të Ministrisë së Financave është realizuar revizion i brendshëm i procesit të menaxhimit të riskut në 7 ministri. Nga 7 revizionet e realizuara:

- me tre revizione është dhënë mendimi se procesi i menaxhimit të riskut është zbatuar në masë të madhe, përkatësisht janë evidentuar devijime të vogla në zbatimin e kërkesave të ligjit dhe dispozitave të tjera që rregullojnë këtë proces dhe metodologjinë e punës të parashikuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit, që mund të eliminohen duke zbatuar rekomandimet. Ekzistojnë mundësi për përmirësime të vogla në hartimin, krijimin dhe funksionimin e procesit të menaxhimit të riskut;
- me tre revizione është dhënë mendim se procesi i menaxhimit të riskut është zbatuar pjesërisht, gjegjësisht janë evidentuar devijime të konsiderueshme në zbatimin e kërkesave të ligjit dhe dispozitave të tjera që rregullojnë procesin e menaxhimit të riskut dhe metodologjinë e punës së siguruar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit që nuk e rregullojnë plotësisht menaxhimin me risqet në institucion. Megjithatë, ekzistojnë mundësi për përmirësime të konsiderueshme në hartimin, krijimin dhe funksionimin e procesit të menaxhimit të riskut, ndërsa zbatimi i rekomandimeve do ta përmirësojë dukshëm atë;
- me një revizion është dhënë mendimi se procesi i menaxhimit të riskut nuk është zbatuar, përkatësisht është konstatuar se ligji, dispozitat e tjera dhe metodologjia e punës së parashikuar nga Njësia Qendrore e Harmonizimit që e rregullojnë procesin e menaxhimit të riskut, nuk janë zbatuar plotësisht, me ç’rast ky proces në institucion nuk është i projektuar, krijuar dhe funksional.

Nga raportimet e dorëzuara dhe veprimet e ndërmarra sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave, revizioni i brendshëm i procesit të menaxhimit të riskut është kryer në 20 komuna (19 komuna dhe Qyteti i Shkupit). Nga 20 revizionet e realizuara të procesit të menaxhimit të riskut:

- me tetë revizione është dhënë mendimi se procesi i menaxhimit të riskut është zbatuar në masë të madhe;
- me tetë revizione është dhënë mendimi se procesi i menaxhimit të riskut është zbatuar pjesërisht;

- me një revizion është dhënë mendimin se procesi i menaxhimit të riskut nuk është zbatuar;

- në tri komuna, revizorët nuk kanë dhënë mendim për nivelin e zbatimit të procesit të menaxhimit të riskut.

Me konkluzionin nr. 3: “Ministritë obligohen që ta përgatisin/përditësojnë planin për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për proceset kryesore të menaxhimit dhe kontrollit financiar me planin për eliminimin e mangësive dhe parregullsive dhe ta monitorojë zbatimin e tij në institucion, ndërsa u rekomandohet njësive të vetëqeverisjes lokale që të veprojnë në këtë drejtim”.

Nga raportimet e dorëzuara, 7 ministri kanë vepruar sipas konkluzionit, gjegjësisht 7 ministri e kanë përgatitur/përditësuar planin për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për proceset kryesore të menaxhimit dhe kontrollit financiar me planin për eliminimin e mangësive dhe parregullsive, me qëllim që më tej të vazhdojnë ta monitorojnë zbatimin e tij në institucion.

Në nivel lokal, nga raportimet e dorëzuara, 13 komuna kanë vepruar sipas konkluzionit, gjegjësisht 13 komuna e kanë përgatitur/përditësuar planin për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për proceset kryesore të menaxhimit dhe kontrollit financiar me planin për eliminimin e mangësive dhe parregullsive, me qëllim të monitorimit të mëtejshëm të zbatimit të tij në institucion.

Në bazë të asaj që u theksua më lartë, Ministria e Financave i propozon Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut që ta shqyrtojë Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2023 dhe t'i miratojë këto:

KONKLUSIONE

1. Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut shqyrtoi dhe miratoi Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2023.
2. Të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë në fushën e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (pushteti qendror) dhe fondet detyrohen ta miratojnë Kodin e Etikës ose ta përditësojnë kodin ekzistues deri më datë 31.12.2024, ndërsa njësitë e vetëqeverisjes lokale rekomandohen që të veprojnë në këtë drejtim dhe nëse është e nevojshme, ndër të tjera, do të përcaktohet mënyra e të vepruarit ndaj rasteve të raportuara të sjelljes joetike, me ç'rast do të caktojnë person të autorizuar të etikës dhe do të krijojnë Komision të Etikës.
3. Të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë në fushën e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (pushteti qendror) dhe fondet detyrohen që deri më datë 31.12.2024, ta vendosin/përmirësojnë procesin e menaxhimit të risqeve, ndërsa njësitë e vetëqeverisjes lokale rekomandohen që të veprojnë në këtë drejtim, respektivisht përmes: hartimit/përditësimit të strategjive të menaxhimit të risqeve, dokumentimit të duhur të risqeve nga puna në Regjistrin e Riskut dhe dokumentet e tyre të planifikimit, si dhe përmirësimit të raportimit për risqet e identifikuara në mënyrë që personi përgjegjës i institucionit të marrë informacion në kohë për risqet më të theksuara të ministrisë dhe të institucioneve në kompetencë të tyre. Njëkohësisht, gjatë përcaktimit të risqeve, duhet të marrin parasysh llojet e ndryshme të risqeve të korrupsionit dhe t'i bëjnë ato pjesë integrale të Regjistrit të Riskut të institucionit.
4. Ministria e Administratës Publike, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave detyrohen që deri në datë 31.10.2024, të vendosë detyrën dhe detyrimin e domosdoshëm të punës në lidhje me procesin e menaxhimit të riskut në aktet e sistematizimit të vendeve të punës për kategorinë e nëpunësve udhëheqës administrativë.
5. Të gjithë shfrytëzuesit buxhetorë të linjës së parë në fushën e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (pushteti qendror) dhe fondet detyrohen që ta hartojnë/përditësojnë planin për zhvillimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për proceset kryesore të menaxhimit dhe kontrollit financiar, me planin për mënjanimin e

mangësive dhe parregullsive për monitorimin e zbatimit të tij në institucion, ndërsa njësitë e vetëqeverisjes lokale rekomandohen që të veprojnë në këtë drejtim.

6. Të gjithë shfrytëzuesit e linjës së parë buxhetore në fushën e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (pushteti qendror) dhe fondet janë të detyruara që të bëjnë rivlerësimin e rekomandimeve të dhëna por të pazbatuara deri më datë 31.12.2024, ndërsa njësitë e vetëqeverisjes lokale rekomandohen që të veprojnë në këtë drejtim, respektivisht me propozimin e revizionit të brendshëm, ti përditësojë në mënyrë adekuate të dhënat e rekomandimeve, me ç'rast rekomandimet që nuk janë më relevante/të zbatueshme do të përjashtohen.
7. Të gjithë shfrytëzuesit e linjës së parë buxhetore në fushën e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor (pushteti qendror) dhe fondet janë të detyruara që ta njoftojnë Ministrinë e Financave – Sektorin e Harmonizimit Qendror të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik për aktivitetet e ndërmarra për konkluzionet deri në datë 10.05.2025, ndërsa njësitë e vetëqeverisjes lokale rekomandohen që të veprojnë në këtë drejtim.
8. Ministria e Financave – Sektori i Harmonizimit Qendror të Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Sektorin Publik detyrohet ta njoftojë Qeverinë me “Raportin vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2024” për zbatimin e konkluzioneve nga “Raporti vjetor për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm financiar publik për vitin 2023”.

SHTOJCA

Pasqyra
e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë dorëzuar
raport financiar vjetor (shtojca 1, 2, 3, 4 dhe 6)

Nr.r.	Emri i institucionit
1.	Drejtoria e Sigurisë së Informacioneve të Klasifikuara
2.	Ministria e Punëve të Jashtme
3.	Inspektorati Shtetëror Devizor
4.	Ministria e Shëndetësisë

Nr.r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr.r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr.r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
1.	Haraçinë	8.	Zelenikovë	15.	Rosoman
2.	Butel	9.	Karbinc	16.	Saraj
3.	Gjevgjeli	10.	Kërçovë	17.	Sopishte
4.	Qyteti i Shkupit	11.	Mavrova dhe Rostusha	18.	Nagoriçani i Vjetër
5.	Demir Kapi	12.	Negotinë	19.	Studeničan
6.	Dojran	13.	Petrovec	20.	Çair
7.	Zhelinë	14.	Rankovcë	/	/

Pasqyra
e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë miratuar Strategji për
menaxhimin e risqeve

Nr.r.	Emri i institucionit
1.	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
2.	Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës
3.	Komisioni Regullator i Banimit
4.	Komisioni i Mbrojtjes nga Diskriminimi
5.	Agjencia Operative dhe Teknike
6.	Këshilli Fiskal
7.	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut
8.	Shërbimi i Punëve të Përgjithshme dhe të Përbashkëta
9.	Ministria e Sistemit Politik dhe Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive
10.	Agjencia e Menaxhimit me Prona të Konfiskuara
11.	Ministria e Mbrojtjes
12.	Agjencia e Sigurisë Nacionale
13.	Drejtoria e Mbajtjes së Librave Amë
14.	Inspektorati i Përdorimit të Gjuhëve
15.	Inspektorati Shtetëror Devizor
16.	Drejtoria e Zonave Zhvillimore Teknologjike dhe Industriale
17.	Inspektorati Shtetëror i Tregur
18.	Ministria e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Ujërave
19.	Inspektorati Shtetëror i Mjedisit Jetësor
20.	Agjencia e Përkrahjes Financiare në Bujqësi dhe Zhvillim Rural
21.	Inspektorati Shtetëror Sanitar dhe Shëndetësor
22.	Inspektorati Shtetëror i Vetëqeverisjes Lokale
23.	Agjencia e Mërgatës
24.	Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut
25.	Byroja e Zhvillimit Rajonal

26.	Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
27.	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
28.	Këshilli i Prokurorëve Publikë

Nr.r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr.r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale	Nr.r.	Njësia e Vetëqeverisjes Lokale
1.	Haraçinë	16.	Zelenikovë	31.	Pllasnicë
2.	Bosilevë	17.	Zërnovcë	32.	Radovish
3.	Bërvenicë	18.	Kavadar	33.	Rankovc
4.	Vasilevë	19.	Kisella Vodë	34.	Rosoman
5.	Vrapçisht	20.	Kërçovë	35.	Saraj
6.	Gjevgjeli	21.	Konçe	36.	Shën Nikollë
7.	Gradsko	22.	Likovë	37.	Sopishte
8.	Dibër	23.	Llozovë	38.	Nagoriçani i Vjetër
9.	Debërc	24.	Mavrova dhe Rostusha	39.	Studenica
10.	Dellçevë	25.	Makedonska Kamenica	40.	Tearcë
11.	Demir Kapi	26.	Mogillë	41.	Tetovë
12.	Demir Hisar	27.	Negotinë	42.	Çair
13.	Dojran	28.	Novac	43.	Çashkë
14.	Dollnen	29.	Novo Sellë	/	/
15.	Zhelinë	30.	Pehçevë	/	/

Pasqyra
e shfrytëzuesve buxhetorë në nivel qendror dhe lokal të cilët nuk kanë hartuar
Regjistër të Risqeve

Nr.r.	Emri i institucionit
1.	Kabineti i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut
2.	Enti Shtetëror i Revizionit
3.	Komisioni Shtetëror i Zgjedhjeve
4.	Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës
5.	Komisioni Regullator i Banimit
6.	Komisioni i Mbrojtjes nga Diskriminimi
7.	Komisioni Shtetëror i Vendimmarrjes në Shkallën e Dytë në Fushën e Mbikëqyrjes Inspektuese dhe Procedurës Kundërvajtëse
8.	Agjencia Operative dhe Teknike
9.	Këshilli Fiskal
